



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Përgjithshëm



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201402252/2

Tiranë ___/___/2014

Lënda: *Rekomandojmë rillogaritjen e masës së pensionit të pleqërisë të shtetasit M.A.*

Drejtuar: **Znj. Vjollca BRAHO**
Drejtoreshë e Përgjithshme e Institutit të Sigurimeve Shoqërore

TIRANË

Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit ka paraqitur ankesë shtetasi M.A, në përmbajtjen e së cilës ankohet për masën e ulët të pensionit të pleqërisë dhe kërkon rillogaritjen e pensionit.

Sipas shpjegimeve të tij, ankuesi ka dalë në pension pleqërie më datë 01.12.2005 me një masë pensioni 8350 lekë, bashkë më kompensimet përkatëse

Ka punuar mbi 40 vjet në sektorët e naftës, nga punët më të vështira, edhe me ndotje ambjenti nga fenolet, karboni e shumë elemente të tjera të rrezikshëm për shëndetin.

Ankuesi pretendon se bazuar në vjetërsinë e përgjithshme të punës, masa e pensionit të tij duhet të ishte më e lartë dhe ka kërkuar ndërmjetësimin tonë institucional për të mundësuar rillogaritjen e pensionit të tij të pleqërisë.

Bashkangjitur ju dërgojmë kopje të:

- Librezës së Pensionit
- Çertifikatës familjare
- Librezës së Punës

Sa më lart, në mbështetje të pikës 3, të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se: "Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike", si dhe në bazë të nenit 21/b të Ligjit Nr.8454

datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, ku thuhet se : "Paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive",

R E K O M A N D O J M Ë:

Rillogaritjen e masës së pensionit të pleqërisë të shtetasit M.A.

Në përputhje me nenin 22 të Ligjit "Për Avokatin e Popullit", ku thuhet shprehimisht se: "Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, duhet ta shqyrtojnë rekomandimin dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit",

Lutemi ta shqyrtoni dhe të na vini në dijeni për qëndrimin tuaj ndaj këtij rekomandimi.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin Tuaj,

K O M I S I O N E R I

Ermir KAPEDANI